

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse Selvije Kostërci, në lëndën penale ndaj të pandehurit B.D., për shkak të veprës penale: Lëndim i lehtë trupor, të parashikuar nën 188 par. 3 e lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2823/2018 të datës 11.09.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 01.03.2019 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Natasa Radovic dhe të pandehurit, me datë 04.03.2019 publikisht shpalli, ndërsa me datë 11.03.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B.D., nga i ati ... dhe e ëma ..., e vajzërisë ..., i lindur me ... në ..., ku edhe jeton, Rr. “...” pn., i ve, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal ..., ashkali, shtetas i Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Me datën 28.07.2018 rreth orës 21:00 min. në ..., në Rr. “...” në shtëpinë e vet i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore viktimës B.B., ashtu që për arsye të një përlëshje e ka sulmuar fizikisht dhe e ka kafshuar me dhëmbë në faqen e djathtë, duke i shkaktuar lëndime në formë të ndrydhjeve të indeve të buta të trupit, lëndime këto të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Me këtë ka kryer veprën penale: Lëndim i lehtë trupore nga neni 188 par.3 e lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj Gjykatat në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 46, 47, 73, të KPRK-së, dhe nenit 365, 450 dhe 463 të KPP-së, e:

G J Y K O N

1. Me dënim me burg në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve.
2. Obligohen i akuzuari që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, dhe atë në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumë prej 20 euro, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumë prej 20€, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
3. Pala e dëmtuar B.B., nga Mitrovica, në lidhje me kërkesën pasurore - juridike udhëzohet në kontest të rregullt civilo-juridik.

Gjykata, në bazë të nenit 47 të KPRK-së dhe me pëlqimin e të akuzuarit, dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 muajve ia zëvendëson me dënim me gjobë, ashtuqë:

4. Obligohet i akuzuari që t'a paguajë gjobën në shumë prej 350 € (treqind e pesëdhjetë euro), të cilën gjobë është i obliguar ta paguajnë në afat tre (3) muajve nga dita e

plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe atë në 3 (tre) këste të barabarta, më së largu deri me datën 5 të muajit vijues. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 46 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë mund t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.2823/2018 të datës 11.09.2018, kundër të pandehurit B.D. nga Mitrovica, për shkak te veprës penale: Lëndim i lehtë trupore nga neni 188 par.3 e lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar ashtu që në këtë seancë i pandehuri e ka pranuar fajësinë në tërësi sipas aktakuzës, duke theksuar se e ndjej veten fajtor për veprën penale që i vihet në barrë, duke shtuar se tashmë unë dhe bashkëshortja jemi ndarë, nuk jetojmë më tutje bashkë, nuk e kam penguar nga ndarja, dhe se nuk kemi probleme sepse nuk jetojmë bashkë.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se i pandehuri e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare, pa presion, i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat juridike të pranimit të fajësisë dhe se janë plotësuar kushtet ligjore sipas KPP-së për pranimin e fajësisë, andaj i propozon gjykatës që ta pranojë pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe me rastin e shqiptimit të dënimit ta merr parasysh si rrethanë lehtësuese.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 248 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykate si: Shkresat e kallëzimit penal 2018-BC-632 datë 29.07.2018; Raporti i Spitalit në Mitrovicë nr. 15855 dt.29.07.2018; Mendimi dhe konstatimi i eksperimentit mjeko-ligjor Dr. F.B. e dt. 10.08.2018; Deklaratën e të pandehurit dhënë në polici të datës 29.07.2018; Deklarata e të dëmtuarës B.B. dhënë në polici dt. 29.07.2018; dhe, Fotografit e të dëmtuarës. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri, ka kryer veprën penale që i vihen në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke i'u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale: Lëndim i lehtë trupore nga neni 188 par.3 e lidhur me par. 1 të KPRK-së, e për të cilën veprën penale është paraparë dënimin me burgim prej 3 (tre) muajve deri në 3 (tre) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe renduese për matjen e dënimit ne mbështetje të nenit 73 të KPP-ës. Si rrethana

rënduese ka gjetur mënyrën e kryerjes së veprës penale gjë që nga provat rezulton se i pandehuri këtë vepër e kishte kryer me dashje dhe se këtë vepër, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, pasi që bëhet fjalë për mbrojtjen e integritetit trupor të individit, rrethanat më të cilat është kryer vepra pasi që kjo vepër është kryer në ambientin familjar, aty ku secili individ e ndien një siguri më të madhe.

Ndërsa, si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, faktin se i njëjti ka shprehur keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rastit, duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë sjelljet e njëjta, sjellja korrekte e të pandehurit në gjykatë.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, Gjykata në përputhje me nenin 47 të KPRK-së si dhe në pëlqimin e të akuzuarit, dënimin me burgim prej 6 muajve, ia ka zëvendësuar me dënim me gjobë, ashtuqë të njëjtin e ka obliguar që ta paguaj shumën prej 350 euro, duke e vlerësuar se ky është një dënim i drejtë dhe i përshtatshëm, në rastin konkret ndaj të akuzuarit.

Gjykata vlerëson se, zëvendësimi i dënimit me burg në dënim me gjobë, ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Poashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 par 1 të KPRK-së, që ti parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Poashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahet nga cenimi i pasurisë së njerëzve.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.1 dhe 2.6 dhe nenit 453 par.1 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e ekspertizës dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimn viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 per Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Për realizimin e kërkesës pasurore juridike, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil, në kuptim të nenit 463 të KPP-së.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 453 te KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.722/2018, dt.11.03.2019

Procesmbajtësja:
Selvije Kostërci

Gjyqtari

Rrahman BEQIRI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.